

Ligji Nr. 9741 dt. 21.5.2007

## PER ARSIMIN E LARTE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

### **Neni 1.**

#### **Qellimi i ligjit**

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë misionin, objektivat kryesorë të arsimit të lartë dhe të rregullojë aspekte të krijimit, organizimit, drejtimit, administrimit, financimit sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në përputhje me standardet europiane si dhe rolin e shtetit e të shoqërisë në arsimin e lartë.

### **Neni 2**

#### **Misioni i arsimit të lartë**

- a) Të krijojë , të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies krijimit shkencor dhe shërbimeve; të formojë specialist të lartë dhe të përgatisë shkencëtar të rinj.

### **Neni 5**

#### **Universitetet**

1. Universiteti përfaqëson një strukturë të përbërë dhe të integruar që realizon arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, shkencës, profesioneve dhe transmeton njohuri në fusha dhe disiplina shkencore dhe profesionale.
2. Universiteti siguron arsimim të bazuar në kërkim dhe njohuri shkencore e teknologjike bashkëkohore; siguron arsimim të vazhduar, kualifikime, specializime përgatit specialist dhe shkencëtar të rinj.
3. Universiteti realizon kërkim shkencor e të aplikuar dhe veprimtari krijuese ofron shërbime në përputhje me misionin e tij, mbështet dhe realizon aftësimin e personelit akademik. Në varësi të misionit kryesor që ka, të përcaktuar në statutin e tij, universiteti siguron raportin e përshtatshëm ndërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve që ofron.

## **Neni 10**

### **Qëndrat dhe institutet e kërkimit dhe të zhvillimit**

1. Qëndrat dhe institutet e kërkimit dhe zhvillimit të institucioneve të arsimit të lartë kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi, si dhe marrin pjesë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë
2. Struktura e qendrave dhe institutive të kërkimit dhe të zhvillimit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tyre përcaktohet në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore që dalin në zbatim të tij

## **Neni 14**

### **Senati akademik**

1. Senati akademik është organ kolegjal vendimmarrës i institucioneve të arsimit të lartë që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.
2. Funksionet kryesore të senatit akademik janë:
  - a) Garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit si dhe të drejtat e studentëve;
  - b) miraton planin disavjecar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarisë së tij;
  - c) vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projektbuxhetin e institucionit pasi merr miratimin nga këshilli i administrimit;
  - d) miraton ndarjen e burimeve financiare;
  - e) miraton projektstatutin e institucionit me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;
  - f) miraton rregulloret e institucionit që janë kompetencë e tij;
  - g) vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit të kërkimit e zhvillimit dhe hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore;
  - h) vlerëson, garanton dhe mban përgjithësi për sigurimin e brëndshëm të cilësisë në institucion në përputhje me standardet shtetërore;
  - i) vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;
  - j) siguron që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha provimeve të bëhet në përputhje me standardet e institucionit që garantojnë cilësinë dhe transparencën e duhur etj.

3. Senati akademik kërkon mendimin e këshillit të administrimit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit.
4. Funksionimi i senatit akademik, përbërja si dhe të drejta dhe detyra të tjera të tij përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë në përputhje me këtë ligj.

## **Neni 25**

### **Programet e studimit**

1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të akredituara, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.
2. Programet e studimeve hartohen nga vetë institucionet dhe miratohen në senatet e tyre akademike.
3. Institucionet e arsimit të lartë shpallin publikisht programet e akredituara të studimeve që ofrojnë para fillimit të aplikimeve për pranime në to.

## **Neni 41**

### **Hapja, mbyllja dhe ndryshimi i një institucioni publik të arsimit të lartë**

1. Hapja e një institucioni publik të arsimit të lartë, mbyllja e tij ose bashkimi me ndonjë institucion tjetër publik të arsimit të lartë bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
2. Hapja e një institucioni të ri publik të arsimit të lartë bëhet me plotësimin e standardeve akademike dhe të kushteve të tjera të përcaktuara në këtë ligj apo në akte të tjera nënligjore të nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit.
3. Mbyllja e një institucioni të arsimit të lartë apo bashkimi me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë kërkon paraprakisht mendimin e senatit akademik ose senateve akademike të institucioneve të arsimit të lartë të përfshira në veprimet respektive.
4. Standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, ndryshimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë miratohen nga Këshilli i Ministrave, sipas propozimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

5. Hapja e njësive kryesore të institucioneve të arsimit të lartë bëhet mbi bazën e propozimit të këtyre institucioneve me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, para se të marrë vendim sipas pikave 2, 3 dhe 5 të këtij neni kërkon vlerësimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.
7. Për institucionet publike të arsimit të lartë që nuk janë në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës këto të drejta i ushtrojnë ministrinë përkatëse.

## **Neni 59**

### **Sigurimi i brëndshëm i cilësisë**

1. Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për sigurimin e brëndshëm të cilësisë dhe ngrenë njësinë përkatëse të sigurimit të brëndshëm të cilësisë. Nëto merr pjesë gjithmonë edhe një përfaqësues nga organizimet studentore të institucionit si dhe një përfaqësues ekspert i jashtëm. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore si dhe të veprimtarive administrative e financiare të institucionit.
2. Kriteret dhe procedurat për ngritjen dhe funksionimin e këtij sistemi hartohen nga institucionet e arsimit të lartë në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe përcaktohen në statutet e institucioneve.
3. Institucionet e arsimit të lartë publikojnë rezultatet e vlerësimit që kryejnë.

## **Neni 60**

### **Sigurimi i jashtëm i cilësisë**

1. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit.
2. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë ose agjenci të tjera akreditimi pjesë e rrjetit European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për organizimin dhe veprimtarinë e këtyre agjencive.
3. Pranë Agjencise Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë funksionon këshilli i akreditimit. Këshilli i akreditimit është një organ kolegjal që rekomandon bazuar në vlerësimin e jashtëm të cilësisë, akreditimin e programeve/institucioneve në arsimin e lartë publik dhe privat.
4. Mandati i anëtarëve të këshillit të akreditimit është 5 vjet.

5. Këshilli i akreditimit ngre edhe komisione të ekspertëve sipas fushave kryesore të arsimit të lartë. Këto komisione kanë karakter të përkohshëm dhe përbëhen nga ekspertë vendas apo të huaj.
6. Funksionimi, fusha e veprimtarisë dhe kompetencat e tjera të institucioneve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.
7. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë hartojnë një raport vjetor të veprimtarisë së tyre i cili bëhet publik.

## **Neni 61**

### **Vlerësimi i cilësisë**

1. Vlerësimi dhe akreditimi mund të jenë në nivel institucional dhe programesh studimi.
2. Vlerësimi dhe akreditimi mbështeten në standardet shtetërore të cilësisë. Këto standard përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Propozimi për standardet shtetërore të cilësisë bëhet nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, mbështetur dhe në udhëzimet e Sigurimit të Cilësisë në Hapsirën Europiane të Arsimit të Lartë.

## **Neni 62**

### **Akreditimi**

1. Ministri i Arsimit dhe Shkencës mbështetur në rekomandimet e këshillit të akreditimit jep vendimin përfundimtar për akreditimin institucional dhe të programeve në arsimin e lartë publik dhe privat. Ai shprehet brenda një muaji në të kundërt këshilli i akreditimit shpall vendimin e tij.
2. Vendimi për akreditimin mund të jetë pozitiv, negativ ose me kusht. Vendimi negativ bën që një institucion ose program të mos njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.
3. Cdo institucion i arsimit të lartë apo program studimi në arsimin e lartë publik apo privat përpara lëshimit të diplomave të para i nënshtrohet procesit të akreditimit të parë. Akreditimi i parë i jep të drejtën një institucioni publik të arsimit të lartë të lëshojë diploma të njohura në Republikën e Shqipërisë.

4. Cdo program/institucion i akredituar i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik. Vlerësimi dhe akreditimi periodik kryehet cdo 6 vjet.
5. Procedurat, kërkesat, kriteret dhe standardet për vlerësimin dhe akreditimin janë të njëjta si për institucionet publike të arsimit të lartë ashtu dhe për ato private.
6. Shpenzimet për vlerësimin e jashtëm të cilësisë përballohet nga vetë institucionet e arsimit të lartë.
7. Rezultatet e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit bëhen publike.

## **Neni 64**

### **Kontrolli i ligjshmërisë**

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës kryen periodikisht të paktën një herë në tre vjet kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në institucionet publike ose private të arsimit të lartë dhe të paktën një herë në vit kontroll financiar në institucionet publike të arsimit të lartë.

## **Neni 65**

### **Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës**

1. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për politikën e zhvillimit në arsimin e lartë dhe shkencën.
2. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës formulon mendime dhe propozime për:
  - a) hartimin e strategjive e programeve kombëtare për arsimin e lartë e kërkimin shkencor, drejtimit e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve ligjore;
  - b) fushat parësore dhe programet e kërkimit shkencor e zhvillimit teknologjik;
  - c) projeksionin e parashikuar për arsimin e lartë dhe shkencën dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij
  - d) Standardet për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë ose programeve të studimeve

- e) kriteret për dhënien e titujve dhe gradës shkencore së bashku me Komisionin e Vlerësimit të Titujve Akademikë
  - f) zhvillimin e politikave të vecanta të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe rrugët e financimit të tyre
3. Veprimtaria e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës ushtrohet në përputhje me rregulloren që miratohet nga Këshilli i Ministrave.

## **Neni 69**

### **Kërkimi shkencor dhe zhvillimi në institucionet e arsimit të lartë**

1. Institucionet e arsimit të lartë kryejnë kërkim shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese në mënyrën e përcaktuar në statutin e institucionit të lartë sipas objektivave specifike të institucionit në këto drejtime.
2. Veprimtaria e kërkimit dhe zhvillimit që kryhet në institucionet e arsimit të lartë synon dhe në rritjen e cilësisë së arsimimit. Ajo u jep studentëve aftësi metodologjike për kërkim, jep mundësi të vazhdueshme në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, përmirëson kualifikimet e personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe krijon mjete, material për zhvillim dhe punën në institucion etj.
3. Personeli akademik është i lirë të kryejë veprimtari kërkimi e zhvillimi për të tretë, por me kusht:
  - a) plotësimin e detyrimeve ndaj institucionit sipas kontratës së punës
  - b) plotësimin e detyrimeve të njësisë përbërëse të institucionit për kërkim shkencor sipas pikës 1 të këtij neni

## **Neni 70**

### **Veprimtaritë kërkimore në institucionet e arsimit të lartë**

1. Veprimtaritë e kërkimit dhe zhvillimit në institucionet e arsimit të lartë duhet të sigurojnë intergrimin e kërkimit me mësimin
2. Temat ose afatet e kërkimit, drejtimit dhe vëllimi i punëve përcaktohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Këto përcaktohen mbështetur në nevojat e zhvillimit të vendit, rëndësinë e kërkimit për arsimimin e studentëve, programet e bashkëpunimit shkencor aftësimin e personelit akademik, si dhe burimet financiare në dispozicion.

3. Institucionet e arsimit të lartë kryejnë për të tretë edhe shërbime të ndryshme të kualifikuara si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime informacioni etj që rregullohen në statutet dhe rregulloret e tyre. Këto veprimtari kryehen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga kjo veprimtari shkojnë tërësisht në favor të institucionit. Kur të ardhurat sigurohen nga veprimtari kërkimore, studimore dhe krijuese të personelit akademik të institucionit një pjesë e tyre mund të përdoren edhe për shpërblimin dhe motivimin e personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të hartojnë programe dhe projekte kërkimore të bashkëpunimit me institucione të tjera publike apo private brenda dhe jashtë vendit si dhe me shoqata, fondacione etj.
5. Këto institucione bëjnë një raport vjetor për veprimtarinë kërkimore-shkencore ose krijuese të cdo lloji.

### **Neni 90**

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë duhet që brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të jetë bërë pjesë e Regjistrit European të Agjencive të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Këshilli i akreditimit riorganizohet sipas këtij ligji brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e tij.

### **Neni 91**

Institucionet e arsimit të lartë të cilat janë krijuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit dhe të akreditimit sipas këtij ligji brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e tij. Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të bëjë publike të gjithë institucionet e akredituara publike, private të arsimit të lartë.